



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosovo



MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

QENDRA E STUDENTËVE
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS
PRISHTINË


MINISTRY OF EDUCATION
OBRAZOVANJE
SCIENCE AND TECHNOLOGY

STUDENTS' CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA
PRISHTINA

MINISTARSTVO ZA
NAUKE I TEHNOLOGIJU

STUDENTSKI CENTAR
UNIVERSITETA PRISHTINE
PRISHTINA

Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976
web: www.qendraestudenteve.com



Në mbështetje të nenit 95 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe nenit 15 pika 2.3 te Statutit te Qendres s e Studenteve te Universitetit të Prishtinës, Drejtori i Pergjithshëm, aprovoi këtë:

RREGULLORE
PËR SIGURINË NË PUNË, MBROJTËJE TË SHËNDETIT TË TË PUNËSUARVE
DHE TË AMBIENTIT TË PUNËS

DISPOZITAT TË PËRGJITHËSHME

Neni1

2.1 Qëllimi Rregullorës për Siguri në punë, mbrojtje të shendetit të të punësuarve dhe të ambientit të punës, është qëllimi që të parandalohën lëndimet në punë, sëmundjet profesionale në ambientin e punës dhe të mbrohet ambienti i punës,

2.2. Vëndi i punës është çdo hapësire ku kryhet vëprimtaria në punë,

2.3. Siguria në punë, mbrojtja e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës është pjesë integrale e organizimit të punës dhe e procesit të punës. (Ajo duhet të vijë në funksion, përmës aktivitetit të punëdhenesit), përmës marrëveshjeve të obligueshme, rregullave të kontraktuara dhe udhëzimeve të përcaktuara nga punëdhënësi,

2.4. Të drejtë për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës me këtë rregullore kanë:

- Përsonat që janë në aftësim profesional te punëdhënsi të cilët nuk kanë themeluar mardhënije punë,

- Përsonat ne rikualifikim profesional dhe rehabilitim,

- Nxënësit dhe studëntet të cilët te punëdhënësi kryejnë punë praktike,

- Pjesëmarrësit në punë vullnetare, apo punë të tjera publike të organizuara për interes të përgjithshëm,

-Personat të cilët gjatë vuajtjës së denimit angazhohen në punë,

1.5. Masat e nderrmara për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës nga punëdhënësi nuk e fut punëtorin në asnje obligim finansiar.

1.6. Punëmarresi duhet t'iu përbahët masave të nevojshme për siguri dhe shëndetin në punë, të kujdeset për shëndetin e tij dhe të pësonave të tjërë të ndikuar nga vëprimet e tij/saj. Në punë duhet të shfrytezon në menyrë të duhur mjetet e sigurisë për punë, paisjet pësonale mbrojtëse dhe këto duhet ti përdor me kujdes dhe secili këto mjete t'i mbaj në gjendje funksionale.

II. OBLIGIMET DHE PËRGJEGJËSITË E PUNËDHËSIT

Neni 2

2.1. Punëdhënesi është i obliguar që të krijoj kushte për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës. Ne rast të sëmundjës profesionale dhe fatkëqësisë-lëndimit në punë, punëtori ka të drëjtë në kompenzim të parapare në dispozitat e ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjit të Punës dhe Kontratës së Përgjithshme kolektive.

2.2. Punëdhënesi është i obliguar të organizoj dhe ndërrmerr masat e nevojshme për sigurinë në punë, mbrojtejen e shëndetit te të punësuarve dhe ambientit të punës, përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë, (ofrim informative), trajnimeve, (organizimit përkates dhe masave të duhura për të siguruar mirëmbajtur makinërinë), instrumentet, paisjet, veglat e vendit të punës, mundësitet për të shkuar në vëndin e punës.

2.3. Punëdhenesi do të kontrolloj efektshmërinë e masave dhe doemos do të ndërmerr masa të duhura për përmisimin e mëtejmë. Qendra e Studentëve konform ligjit për sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit te të punësuarve dhe ambientit të punës, do të caktoj një referent profesional, për siguri në punë.

2.4. Punëdhenesi do të bëjë vlëresimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilin vënd të punës. Vendet e punës të ngajashme mund të grupohen. Rreziqet në veçanti mund të adresohen nga:

2.4.1. Konstruktimi dhe paisjet në vendi e punës,

2.4.2. Ndikimet fizike, kimike dhe biologjike,

2.4.3. Konstruktimi, zgjedhja dhe perdonimi i mjeteve, materialit, përbërsve të paisjeve dhe zbatimi i tyre,

2.4.4. Konstruktimi i sistemeve të punës, prodhimi, rrjedhës së punëve, orarit të punës dhe ndikimet e ndërsjellt,

2.4.5. Kualifikimi dhe trajtimi i punëtorëve (punmarrësve) me standarde evropiane.

2.5 Punëdhënesi pajisë të punësuarit me paisjet profesionale mbrojtëse e cila është e paraparë për mbrojtjën kundër ekspozimit të dëmtimëvë dhe rreziqëve në punë. Punëdhësi do ti bartë shpenzimet dhe do të bëjë zevendesimin e paisjeve personale mbrojtëse në intervale të rregullta kohore dhe çdo hënë kur është e domosdoshme,

2.6. Punëdhenesi obligohet që në rast të lëndimeve, ose sëmundjes së papritur, punëmarresi t'i siguroj:

-Dhënjen e ndihmës së parë ,

-Të siguroj evakuimin e të punësuave-lënduarve në mënyre adekuate të natyrës së vëprimtarisë së punëdhënësit,

-Siguroj dhe organizoj kontakte me shërbim përkatës,

-Dhënjes së ndihmës urgjente,

-Kujdesit urgjent mjekSOR-emergjencës,

-Mbrojtjën kunder zjarrit,

-Aftesimit e numrit të caktuar të punëmarrësve për dhenjen e ndihmës së parë,



-Shpëtimit dhe evakuimit të punëmarresve në rast rreziku të mundshem.

2.7. Punëdhënësi duhet ta informoj punëtorin për punët të cilat kryhen nga ai/ajo.

Punëdhënësi duhet ti informoj punëtoret te cilët do ti ekspozohen rrezikut të lartë sa më parë që të jëtë e mundëshme rrëth rrëziqeve dhe masat për mbrojtje në punë për të minimizuar rrezikun.

2.8. Në rast të rrezikut të pashmangshëm, kërcenues për vetë dhe për personat të tjerë punëtorit iI lëjohet për të zbatuar kundërmasa të përshtatshme, nëse mbikqyrësi nuk është aty. Duke patur parasysh trajnimin që është bërë dhe mjetet teknike në dispozicion, punëtori nuk do të pësojë dëme për aktet e tillë, përvçët në rastët e nënglizhencës flagrante, ose sabotim të qellimit.

2.9. Punëdhënësi duhet ta trajnoj punëtorin për punë në atë mënyrë e cila siguron mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të tij/saj dhe e cila parandalon fatkeqësinë në punë.

2.10. Punëdhënësi do ta informoj menjehër organin kompetent për të gjitha rastet e vdekjes në punë, fatkeqësive të rënda në punë, apo që kanë të bëjnë me punën.

2.11. Punëdhënësi i përgjigjet punëmarresit për dëmin e shkaktuar për rastin e lëndimeve në punë dhe sëmundjeve profesionale që kanë të bëjnë më punën sipas parimit të përgjegjesis objektive të së drejtes detyrimore,

2.12. Sëmundjet profesionale do të përcaktohen me ligjin përkatës për shëndetësinë dhe mbrojtjen shëndetësore.

III. TË DREJTAT DHE PËRGJITHËSIT E PUNËTORIT (PUNËMARRËSIT)

Neni 3

3.1 Punëmarrësi ka të drejtë dhe obligim për sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe ambientit të punës.

3.2. Punëmarresi është i obliguar t'u përbahet masave të nevojshme për sigurinë në punë mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës. Kujdesët për sigurinë dhe shëndetin e tij/saj dhe të pësonave të tjerë të ndikuar nga veprimet e tij/saj në punë, shfrytezon në mënyrë të duhur mjetet e sigurisë dhe i përdorë ato me kujdes dhe ne gjendje funksionale. Punëmarresi gjithëashtu duhet të kënë përgjithesi për të siguruar mbrojtjen dhe shëndetin e të gjithë pësonave të ndikuar nga veprimet në punën e tyre.

3.3. Eshtë e drejtë e punëtorëve ose e organizatave të tyre ti zgjedhin ose emërojnë përfaqsysit të tyrë për sigurinë në punë mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës. Pësoni e tille do të mbikqyre zbatimin e masave të ndërmarra nga punëdhënësi dhe do të bashkepunojë me Inspektoratin e Punës në interest ë punëtorëve në sferen e sigurisë në punë mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës.

3.4. Punëtori duhet menjëherë ta njoftoj punëdhënësin e tij për çdo mangesi, rrezik, shëndetësor, ose ndonjë dukuri tjetër e cila mund ta rrezikoj sigurinë tij/saj ose të punëtorëve tjerë.

3.5. Punëtori ka të drejtë ta refuzoj punën nëse ai/ajo ka arsyë të besoj së ekxiton rrezik i dretpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e tij/saj. Nëse punëdhënësi konsideron se refuzimi i punës është i pabazuar, duhet ta lajmëroj Inspektorin e Punës.

3.6. Punëtori bashkëpunon më punëdhënësin dhe zyrtarin për siguri në punë për tu siguruar se mqedisi i punës dhe kushtet janë të sigurta dhe se masat e urdhëruara nga Inspektori i Punës zbatohen nga punëdhënësi.

3.7. Eshtë e drejtë e punëtorit dhe e organizatavë të tyre që të konsultohen me punëdhënësin në të gjitha aspektet e sigurisë në punë, mbrojtjës së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës lidhur me punën e tyre,

3.8. Punëtori do të shfrytezojë të gjitha makinat, paisjet, veglat, materialin e punës dhe mjetet e transportit si dhe aparatet e sigurisë, dhe paisjet personale mbrojtëse (PPM) në pajtim me udhëtimet specifike të aplikimit.

3.9. Punëtori ka të drejtë të sugjeroj përmirësimin e situatës së mbrojtjes dhe të shëndetit në vëndin e punës.

3.10. Punëtori ka të drejtë të raportojë mungesat e PPM-ve dhe masat e sigurisë në vendin e punës, në mënyrë të drejtpërdrejtë Inspektorit i Punës me kusht që ata/ato të kenë baza konkrete për të besuar së masat e mbrojtjës në punë të zbatuara nga punëdhënësi janë të pamjaftueshme dhe si shëtitë punëdhënësi nuk e ka evituar rrezikun.

Në këtë rast për punëtori nuk do të ketë pasoja.

IV. MBROJTJA E TË RINJËVE, GRAVE DHE PERSONAVE ME AFTESI TË KUFIZUAR

Neni 4

4.1. Punëtori deri në moshën 18 vjeçare, gratë shtatzëna, personat me aftesi të kufizuar për punë nuk mund të sistemohen në këto vende të punës:

4.2. Vëçanërisht të rënda.

4.3. Punë më gjatë se orari i plotë i percaktuar i punës dhe

4.4. Në punë të natës,

V. TOALETËT DHE DHOMAT PËR NDËRRIM

Neni 5

5.1. Punëdhënësi duhet të vë në dispozicion të të punësuarve numër të mjaftueshëm të toaletëve dhe dhomat e ndërrimit ndaras për femra, ndaras për meshkuj dhe t'i mirëmban në mënyrë adekuate.

VI. VËNDET PËR NGRËNJE (KUZHINA)

Neni 6

6.1. Punëdhënësi duhet të ofroj vende për ngrënje, me lagështi të lejuar, të pastruar dhe me nxehësi të mjaftueshme, të ventilar dhe të pandikuar nga atmosfera e dëmshme.

6.2. Vëndet e ngrenjës duhet të pajisen me mobilje të posaqme.

6.3. Puna ne kuzhine organizohet ne dy nderrime. Nderrimi i pare fillon punen nga ora 7 e mengjesit dhe perfundon ne ora 14. Nderrimi i dyte fillon punen ne ora 14 ndersa perfundon punen ne ora 21.

6.4. Orari per ushqim per punetorët, fillon per mengjes nga ora 9-9³⁰, ndersa per drekë nga ora 16-16³⁰.

6.5. Orari per studentët per drekë, fillon nga ora 10-14⁴⁵ ndera per darkë, nga ora 17-20⁴⁵.

6.6. Gjate vikendit orari i punetorëve të kuzhines është nga ora 07⁰⁰-14⁰⁰.

6.7. Orari per ushqim per studentë gjatë vikendit eshte 10⁰⁰-13⁴⁵.

6.7. Kuzhina pastrohet çdo ditë gjatë orarit te punes, ndersa restoranti pastrohet po ashtu çdo ditë, por pas orarit te punes. Çdo te dielë bëhet pastrimi gjeneral i kuzhines dhe restoranit pas orarit te punes.

6.8. Uniforma është e obliguar qe te vishet. Kjo perbehen; mantelet, kapelat, kecelet, jelekët, kllompet, qizmet. Keto rroba sipas normativit ju ipen punetoreve për çdo 6 muaj.

6.9. Kontrolli i ushqimit behet nga Shefi i nderrimit dhe perpiluesi i menysë ushqimore. Po ashtu gjatë çdo nderrimi, Shefi i nderrimit merr mostrat e ushqimit te cilat ruhen ne frigorifer 72 orë.

VII. NDOTJA E AJRIT

Neni 7

7.1. Niveli i ndotjës nga pluhuri dhe gazrat, duhet të matet dhe të kontrollohet në institucionet e autorizuara përkatëse. Pluhuri dhe gazrat duhet të pastrohen përmes ventilimit dhe formave të tjera në atë menyrë që të parandalojë koncentrimin që dëmtojnë shëndetin, ose pëngojnë pamjen konform standardeve europiane.

7.2. Në ambientet e mbylluara të punës ndalohet pirja e duhanit,

7.3. Punëdhënësi është i obliguar të caktoj hapësirë ku është e lejuar pirja e duhanit dhe siguroj ato vende,

7.4. Hapësira ku është e lejuar pirja e duhanit, caktohet me vëndim të posaçëm të përfaqesuesit të punëdhënësit (drejtoretat),

7.6. Punëdhënësi është i obliguar që të siguroj sasi të mjftueshme të ujit të pijshëm për të punësuarit sipas natyrës së punës dhe vendit të punës.

VIII. ZHURMA, DRIDHJA DHE DRITA

Neni 8

8.1. Zhurma, drita dhe dridhja duhet të maten dhe të kontrullohen nga institucionet e autorizuara përkatëse.

8.2. Niveli i zhurmës dhe dridhjes, duhet të rregullohet dhe të sillet në kufijtë e lejuar në pajtim me minimumin e standardeve europiane.

IX. NDRIQIMI

Neni 9

9.1. Në çdo vend të punës duhet të sigurohet ndriqimi i mjaftueshëm, natyral ose artificial dhe mbrojtje nga ndriqimi i tepërt.

X. RRËZIQUET NGA ELEKTRICITETI

Neni 10

10.1. Të gjitha paisjet elektrike duhet ta kenë tiketën, në të cilën shënohen karakteristikat e tyre me simbolin CE. Instalimet e rrymës, duhet të bëhen ne pajtim me standartet europian (EN).

10.2. Masat për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës nga rryma elektrike, do të definoohen me akt të posaçëm (dhe ambientit të punës nga rryma elektrike, do të definoohen me akt të posaçëm (plan emergjent).

XI. PRODHIMET KIMIKE

Neni 11

11.1. Të gjitha substancat kimike, përfshirë pesticidet, alkalet dhe substancat tjera korozive duhet të deponohen dhe të përdoren në pajtim me standartet europiane mbi kontrollimin e substancave të rrezikshme për shëndetin.

XII. ZJARRI

Neni 12

12.1. Vëndi i punës duhet të jete I paisur me mjete përkatëse kundër zjarrit në pajtim më planin emergjent.

12.2. Të punësuarit duhet të trajnohen nga punëdhënësi, në përdorimin e drejtë të mjeteve në pajtim me planin emergjent dhe raste emergjente të veprohet sipas planit për evakuim.

12.3. Në raste emërgjente, daljet emergjente duhet të janë qart të shënuara dhe duhet të kene ndriqim emergjent.

12.4. Ruga nga dalja emergjente duhet të mos ketë pengesa, si dhe dyertë e daljes emërgjente nuk guxojnë të janë të mbyllura më çelës.

12.5. Në vendet e punës me më shumë së 20 të punësuar, punëdhënësi është i obliguar ta ketë planin për evakuim emërgjent.

XIII. DOKUMENTACIONI DHE SHËNIMI

Neni 13

13.1. Punëdhënësi duhet të mbajë:

- çertifikatën teknike te cilat qartë specifikojnë aplikimin e rregullavë të sigurisë në punë, për shëndet te të punësuarve dhe ambient të punës, për lokalet, pjesët e lokaleve të shfrytezuara si dhoma pune dhe dhoma ndihmëse në përdorim,

- udhëzimet mbi përdorimin e gjithë makinerisë dhe paisjeve ne procesin e punës, - çertifikatat të cilat vërtetojnë së instalimet janë në rregull dhe tregojnë qartë karakteristikat e makinerisë në përdorim, në pajtim me standartet europiane.

13.2. punëdhënësi duhet të mbajë evidencën për:

- programet për trajnimin e punëtorëvë për kryerjen e punëve në menyrë të sigurtë
- kontrollimin paraprak dhe perioden e kontrollimeve mjeksore te punetorëve të cilët kryhejnë punë në kushte të veqanta të punës,
- substancat të rrëzikshme të cilat prodhohen,
- Aksidentet në punë, rastët e lëndimeve të rënda, vdekjeve në punë dhe rastet e sëmundjeve profesionale,
- rezultatët e të gjitha vlerësimëve përrëziqet, masave të nderrmarra për t'i eliminuar rrëziqet e tillë dhe rezultatet e kontrollimeve mbi efektëshmeritë e masave të tillë,
- ndryshimet në proceset teknologjike të cilat rrëzikojnë, ose mund të paraqesin rrezik përsigurinë në punë, mbrojtejen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës.

XIV. PAISJET PËRSONALE MBROJTËSE TË TË PUNËSUARËVE

Neni 14

- 14.1. Punëdhënësi, pajisë të punësuarin me pajisje përsonale mbrojtëse e cila është e paraparë për mbrojtjën kundër ekspozimit të dëmtimeve dhe rreziqeve në punë.
- 14.2. Punëdhënësi do t'i bartë shpënzimët dhe do të bëjë zëvendesimin e paisjeve përsonale mbrojtëse në intervalë të rregullta kohore, dhe ç'do here kur është e domosdoshme.
- 14.3. pajisjet përsonale mbrojtëse të punëtorëve janë:
- Rrobat mbrojtëse të punës dhe
 - Mjetët e sigurisë në punë,

XV. RROBAT MBËROJTËSE TË PUNËS PËR TE PUNESUARIT NE DREJTORI DHE SEKTORE

Neni 15

- 15.1. Rrobat mbrojtëse te punes jane gjate sezonit dimeror dhe veror,
- 15.2. Rrobat mbrojtëse të punes (per dy gjinitë) kanë afatet e qendrueshmerisë nga 1, 2 dhe 3 vite, apo më shumë nese kjo percaktohet nga udheheqesi i drejtperdrejt, apo udheheqesi i lartë, (drejtori),
- 15.3. Afati i tyre rregullohet me një liste te veçantë nga secili sektor i perkates i punes,

XIV. NGARKIMI, PËRDORIMI DHE KUSHTET E KTHIMIT TË RROBAVE MBËROJTËSE TË PUNËS, NGA ANA E PUNËTORIT

Neni 16

- 16.1. Punëtori ngarkohet me rroba mbrojtëse të punës, nëpërmes reversit të depos të punëdhënësit,
- 16.2. Punëtori është i obliguar që rrobat mbrojtëse të punës të përdor vetëm gjatë orarit të punës dhe të njëjtat t'i mirëmbaj në gjendje të rregullt higjenike,
- 16.3. Punëtori obligohet që nëse i dëmton rrobat mbrojtëse të punës me fajin e tij dhe atë para skadimit të afatit të qëndrueshmërisë së tyre, ti kompensoj me mjete materiale vetanake,
- 16.4. Punëtori është i obliguar që nëse ndërkohë sistemohet në vendin tjetër të punës, apo i ndërpritet mardhënia e punës (kontrata e punës) sipas ligjit, të shkarkohet, sipas reversit në depon e Qendres së Studentëve,
- 16.5. Në rast se punëtori nuk vjen në punë me rrobat mbrojtëse të punë, atëherë do t'i hiqet mëditja e plotë e punës,
- 16.6. Qendra e studentëve dhe para skadimit të afatit është I obliguar që ta furnizojë me rrobat e reja të mbrojtëjes në punë punëmarrësin, nëse konstatohet se ato janë dëmtuar gjatë orarit të punës dhe atë pa fajin e punëmarresit.
- 16.7. Obligohet punëtori i ngarkuar me rroba, që rrobat e sezonit dimëror t'i përdorë, prej dt. 15.10. deri me 01.05. ndersa ato të sezonit veror, prej datës. 01.05. deri me datën 15.10. të çdo viti.
- 16.8. Obligohet Qendra e Studentëve që në të gjitha rrobat mbrojtëse të punës, ta vendos shenjën-emrin QS-së, në sipërfaqen e përparme, anësore dhe atë të mbrapme.

XVII. MJETET E SIGURISË NË PUNË
Neni 20

17.1. Obligohet Qeëndra e Studentëve, që gjatë orarit të punës t'i pajisë të punësuarit me mjetet e sigurisë në punë,

17.2. Obligohet punëtori i ngarkuar me mjete te punes qe gjate punes ti perdon ato ne menyre te rregullt, në të kundertën do t'i bartë të gjitha përgjigjësitë,

17.3. Mjetet e sigurisë në punë, për të punëtorët janë të evidentuara sipas vendit te punjes ne pranë shërbimit teknik,

17.4. Afatet e mjeteve te punes jane; nga 1 deri ne 10 vite,

17.5. Afatet jane te percaktuara me një liste te veçantë nga sherbimi perkates i punes,

XVIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 21

18.1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje interpretohen dhe zbatohen në pajtim me Ligjin dhe dispozitat tjera me të cilat rregullohen maredheniet e punës së punëtoreëve në QS,

18.2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullorëje pushojnë të vlejnë dispozitat e Rregulloreve për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarëve dhe ambientit të punës nr. 229, të dt. 10.03.2006,

18.3. Rregullorja hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit nga Drejtorati i Përgjithshëm i QS-së.

Prishtinë, 29.03 2017

